



POSTA SHQIPTARE SHA

PASQYRAT FINANCIARE TE KONSOLIDUARA 2012

Përmbajtja

Bilanci i Konsoliduar i Gjendjes Financiare	3
Pasqyra e Konsoliduar e Rezultatit dhe të Ardhurat Gjithpërfshirëse	4
Pasqyra e Konsoliduar e Flukseve Monetare	5
Pasqyra e Konsoliduar e Ndryshimit të Kapitalit	6
Shënime Shpjeguese për Pasqyrat Financiare të Konsoliduara	7
1. Politikat kryesore kontabël	7
2. Të ardhurat nga shitja	13
3. Të ardhura të tjera	13
4. Shpenzime materiale dhe të konsumueshme	13
5. Shpenzime personeli	14
6. Shpenzime amortizimi dhe zhvlerësimi	14
7. Shpenzime të tjera operacionale	15
8. Të ardhura/shpenzime financiare neto	16
9. Tatimi mbi fitimin	16
10. Të ardhurat e tjera gjithpërfshirëse	17
11. Aktivët afatgjata jomateriale	17
12. Aktivët afatgjata materiale	18
13. Aktivët afatgjata financiare	19
14. Investimi Interpost	19
15. Inventarët	20
16. Llogari të arkëtueshme tregtare	20
17. Llogari të tjera të arkëtueshme afatshkurtra	21
18. Mjete monetare	21
19. Detyrime afatgjata	22
20. Llogari të pagueshme	22
21. Detyrime tatimore	22
22. Të tjera detyrime afatshkurtra	23
23. Grande dhe të ardhura të shtyra	23
24. Fitime të pashpërndara	23
25. Menaxhimi i riskut financiar	24
26. Administrimi i kapitalit	25
27. Transaksionet me palët e lidhura	25
28. Ngjarje pas datës së bilancit	25
Raporti i Auditorëve të Pavarur	26

Bilanc i Konsoliduar i Gjendjes Financiare

Të gjitha shifrat në Lekë	Shënime	Konsoliduar		Posta Shqiptare		Interpost	
		Në datën 31 Dhjetor		Në datën 31 Dhjetor		Në datën 31 Dhjetor	
		2012	2011	2012	2011	2012	2011
Aktivët							
Aktivët afatgjata materiale	12	1,874,947,516	1,878,251,134	1,708,939,856	1,878,251,134	166,007,660	0
Aktivët afatgjata jomateriale	11	44,987,436	2,508,044	44,987,436	2,508,044		
Aktive afatgjata financiare	13	450,000,000	450,000,000	450,000,000	450,000,000		
Investimi Interpost	14	75,070,482	0	285,566,422	0	75,070,482	0
Total Aktivët Afatgjata		2,445,005,434	2,330,759,177	2,489,493,714	2,330,759,177	241,078,142	0
Inventarët	15	152,156,281	121,068,154	152,156,281	121,068,154		
Llogari të arkëtueshme tregëtare	16	939,555,451	375,446,078	939,555,451	375,446,078		
Llogari të tjera të arkëtueshme	17	283,936,792	324,913,899	270,188,136	324,913,899	13,748,656	0
Mjete Monetare	18	1,540,385,590	1,729,455,971	1,538,558,521	1,729,455,971	1,827,069	0
Total Aktivët Afatshkurtra		2,916,034,115	2,550,884,101	2,900,458,390	2,550,884,101	15,575,725	0
Total Aktive		5,361,039,549	4,881,643,279	5,389,952,104	4,881,643,279	256,653,867	0
Kapitali dhe Detyrimet							
Kapitali aksionar		1,642,447,000	1,642,447,000	1,642,447,000	1,642,447,000	1,000,000	0
Rezerva nga rivlerësimi		536,878,497	565,261,201	536,878,497	565,261,201		
Rezerva të tjera		94,069,320	83,666,991	94,069,320	83,666,991		
Fondi i Zhvillimit		888,294,591	711,446,770	888,294,591	711,446,770		
Fitime/Humbje të pashpërdara	24	46,253,575	17,870,871	46,253,575	17,870,871		
Fitime/Humbje të ushtrimit		154,131,227	208,055,721	183,618,012	208,055,721	(29,486,785)	0
Total Kapitali dhe Fondet e Veta		3,362,074,210	3,228,748,553	3,391,560,995	3,228,748,553	(28,486,785)	0
Të tjera detyrime afatgjata	19	450,000,000	450,000,000	450,000,000	450,000,000	284,566,422	0
Total Detyrime Afatgjata		450,000,000	450,000,000	450,000,000	450,000,000	284,566,422	0
Llogari të pagueshme	20	154,384,200	332,720,539	154,384,200	332,720,539		
Detyrime tatimore	21	46,247,765	48,417,972	45,693,535	48,417,972	554,230	0
Detyrime afatshkurtra të Tjera	22	1,339,571,420	814,790,819	1,339,551,420	814,790,819	20,000	
Grante dhe të ardhura të shtyra	23	8,761,955	6,965,395	8,761,955	6,965,395		
Total Detyrimet Afatshkurtra		1,548,965,340	1,202,894,726	1,548,391,110	1,202,894,726	574,230	0
Total Detyrime		1,998,965,340	1,652,894,726	1,998,391,110	1,652,894,726	285,140,652	0
Total Kapitali dhe Detyrimet		5,361,039,549	4,881,643,279	5,389,952,104	4,881,643,279	256,653,867	0

Drejtoreshë Finance-Kontabiliteti
Drita BAKIU

Drejtori i Përgjithshëm
Arqile GOREA

Pasqyra e Konsoliduar e Rezultatit dhe të Ardhurat Gjithpërfshirëse

Të gjitha shifrat në Lekë	Shënime	Konsoliduar		Posta Shqiptare		Interpost	
		Periudha vjetore		Periudha vjetore		Periudha vjetore	
		2012	2011	2012	2011	2012	2011
Te ardhura nga shitja	2	1,867,120,908	1,859,206,177	1,867,120,908	1,859,206,177		
Të ardhura të tjera Operative	3	151,740	84,011	151,740	84,011		
Materiale te para dhe te konsumeshme	4	(205,371,827)	(179,305,844)	(205,371,827)	(179,305,844)		
Shpenzime personeli	5	(1,054,545,886)	(966,625,766)	(1,054,545,886)	(966,625,766)		
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	6	(166,559,244)	(138,061,169)	(137,072,459)	(138,061,169)	(29,486,785)	0
Shpenzime te tjera	7	(310,242,906)	(409,836,806)	(310,242,906)	(409,836,806)		
Total Shpenzime		(1,736,719,863)	(1,693,829,584)	(1,707,233,078)	(1,693,829,584)	(29,486,785)	0
Fitimi Operativ		130,552,785	165,460,604	160,039,570	165,460,604	(29,486,785)	0
Te Ardhura/Shpenzime financiare Neto	8	49,642,971	36,889,222	49,642,971	36,889,222		
Rimarrje rezerv a rivlerësimi	10	0	30,106,430	0	30,106,430		
Fitimi para Tatimit		180,195,756	232,456,256	209,682,541	232,456,256	(29,486,785)	0
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	9	(26,064,529)	(24,400,533)	(26,064,529)	(24,400,533)		
Fitimi (Humbja) neto i Periudhës		154,131,227	208,055,723	183,618,012	208,055,723	(29,486,785)	0
<i>Elemente te te Ardhurave Gjithpërfshirëse</i>							
Rimarrje rezerv a rivlerësimi	10	28,382,704	0	28,382,704	0		
Totali i te ardhurave te tjera gjithpërfshirëse		182,513,931	208,055,723	212,000,716	208,055,723	(29,486,785)	0

Drejtoreshë Finance-Kontabiliteti
Drita BAKIU

Drejtori i Përgjithshëm
Arçile GOREA

Pasqyra e Konsoliduar e Flukseve Monetare

Metoda indirekte

Të gjitha shifrat në Lekë	Shënime	Konsoliduar		Posta Shqiptare		Interpost	
		Periudha vjetore		vjetore		Periudha vjetore	
		2012	2011	2012	2011	2012	2011
<i>Veprimtaritë e shfrytëzimit</i>							
Fitimi/humbja para tatimit		180,195,756	202,349,826	209,682,541	202,349,826	(29,486,785)	0
Rregullimet për:							
Amortizimin	6	166,559,244	138,061,169	137,072,459	138,061,169	29,486,785	0
Humbjen nga nxjerrja jashtë përdorimit e AAGJ		261,207	1,335,801	261,207	1,335,801		
Provizionet		0	0	0	0		
Rimarrje		0	0	0	0		
Shpenzimet e interesit		0	0	0	0		
Ndryshimet në kapitalin punues:							
Pakësimi/(Rritja) i inventarëve		(31,088,127)	111,269,458	(31,088,127)	111,269,458		
Pakësimi/(Rritja) i llogarive të arkëtueshme		(564,109,372)	(92,066,579)	(564,109,372)	(92,066,579)		
Pakësimi/(Rritja) i llogarive të tjera të arkëtueshme		40,977,107	121,424,906	54,725,763	121,424,906	(13,748,656)	0
Rritja/(Pakësimi) e llogarive të pagueshme		(178,336,339)	(67,338,027)	(178,336,339)	(67,338,027)		
Rritja/(Pakësimi) e llogarive të tjera të pagueshme		524,406,953	158,295,536	523,832,723	158,295,536	574,230	0
Tatim mbi fitimin i paguar gjatë vitit		(26,064,529)	(38,466,733)	(26,064,529)	(38,466,733)		
Fluksi monetar neto nga veprimtaritë e shfrytëzimit		112,801,899	534,865,357	125,976,325	534,865,357	(13,174,426)	0
<i>Veprimtaritë investuese</i>							
Blerja e AAGJ		(206,996,226)	(201,857,913)	(296,068,203)	(201,857,913)	(195,494,445)	0
Investimi Interpost	14	(75,070,482)	0			(75,070,482)	0
Fluksi monetar neto i përdorur në veprimtaritë e investimit		(282,066,708)	(201,857,913)	(296,068,203)	(201,857,913)	(270,564,927)	0
<i>Veprimtaritë financuese</i>							
Emetim i kapitalit		1,000,000	0			1,000,000	0
Dividendë të paguar		(20,805,572)	(29,758,667)	(20,805,572)	(29,758,667)		
Hua afatgjata	14					284,566,422	0
Fluksi monetar neto i përdorur në veprimtaritë financuese		(19,805,572)	(29,758,667)	(20,805,572)	(29,758,667)	285,566,422	0
Rritja/Pakësimi neto i Mjeteve monetare gjatë vitit		(189,070,381)	303,248,777	(190,897,450)	303,248,777	1,827,069	0
Mjete monetare dhe ekuivalentë në fillim të vitit		1,729,455,971	1,426,207,194	1,729,455,971	1,426,207,194	0	0
Mjete monetare dhe ekuivalentë në fund të vitit		1,540,385,590	1,729,455,971	1,538,558,521	1,729,455,971	1,827,069	0

Drejtoreshë Finance-Kontabiliteti
Drita BAKIU

Drejtori i Përgjithshëm
Arqile GOREA

Pasqyra e Konsoliduar e Ndryshimit të Kapitalit

Të gjitha shifrat në Lekë	Kapitali aksioner	Rezervë rivlerësimi	Rezerva ligjore	Rezerva të tjera	Fitime të pashpërndara	Fitime të Ushtrimit	TOTAL
Gjendja më 31 Dhjetor 2010	1,642,447,000	595,367,631	68,787,657	458,498,104	17,870,871	297,586,667	3,080,557,930
<i>Ndryshimet në kapitalin neto për vitin 2011</i>							
Fitimi për periudhën						177,949,293	177,949,293
Transferim i rezervës nga rivlerësimi		(30,106,430)				30,106,430	0
Rritja e rezervës së kapitalit			14,879,333	252,948,666		(267,827,999)	0
Dividendët						(29,758,667)	(29,758,667)
Gjendja më 31 Dhjetor 2011	1,642,447,000	565,261,201	83,666,990	711,446,770	17,870,871	208,055,724	3,228,748,556
<i>Ndryshimet në kapitalin neto për vitin 2012</i>							
Fitimi për periudhën						154,131,227	154,131,227
Transferim i rezervës nga rivlerësimi		(28,382,704)			28,382,704		0
Rritja e rezervës së kapitalit			10,402,330	176,847,821		(187,250,151)	0
Dividendët						(20,805,573)	(20,805,573)
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	1,642,447,000	536,878,497	94,069,320	888,294,591	46,253,575	154,131,227	3,362,074,210

Drejtoreshë Finance-Kontabiliteti
Drita BAKIU

Drejtori i Përgjithshëm
Arqile GOREA

Shënime Shpjeguese për Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

Për vitin që mbyllet në 31 Dhjetor 2012

1. Politikat kryesore kontabël

Informacione të përgjithshme

Shoqëria Posta Shqiptare sha është krijuar si shoqëri anonime me Vendim të Gjykatës së Rrethit Tirane Nr. 20718 date 03/02/1999. Aksioner i shoqërisë është Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatëse të Ligjit 7638 date 19.11.1992, "Per Shoqëritë Tregtare" dhe në vijim nga ligji Nr.9901 dt 14.04.2008, si dhe nga statuti i saj dhe legjislacioni shqiptar në fuqi. Shoqëria gjithashtu është institucion financiar jobankar i licensuar si e tillë nga Banka Qëndrore dhe raporton në mënyrë specifike për këtë qëllim.

Shoqëria kryen aktivitetin e saj në ambiente që janë në pronësi të saj. Aktivet e qëndrueshme prona të saj përbehen nga toka, ndërtesa, pajisje informatike, mjete transporti etj. Kapitali i shoqërisë sipas vendimit të Gjykatës së Rrethit Tirane përbehet nga kontributet e aksionerit të vetëm Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës në shumën 1.642.447.000, leke i ndare në 1.642.447 aksione me vlerë nominale 1000 leke secili, të cilat zotërohen 100% nga Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës.

Shoqëria Posta Shqiptare sha drejtohet nga Këshilli Mbikqyres, i cili ka emëruar si Drejtor Zotën Arqile Gorea. Drejtorja ka autorizuar publikimin e pasqyrave financiare të konsoliduara në datën 28 Shkurt 2013.

Bazat e përgatitjes

Deklarata e përputhshmërisë. Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Nderkombetare të Raportimit Financiar (SNRF) të Publikuara nga Bordi i Standarteve Nderkombetare të Kontabilitetit (IASB) dhe interpretimeve të publikuara nga Komiteti Nderkombetar i interpretimeve të Raportimit Financiar ("IFRIC") të ISAB. Standartet janë zbatuar deri në nivelin që ato janë përkthyer dhe adoptuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit në Shqipëri (KKK). Në rastet kur këto përkthime të KKK nuk parashikojnë çështje të veçanta, janë zbatuar parashikimet në Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në gjuhën angleze.

Baza e matjes. Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në parimin e kostos historike, bëjnë përjashtim disa elemente të instrumentave financiarë, si bonot e thesarit, si edhe aktivet afatgjata materiale të cilat paraqiten me modelin e vlerës së drejtë.

Monedha funksionale dhe raportuese. Pasqyrat financiare janë përgatitur në Lek, e cila është monedha funksionale për shoqërinë.

Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve. Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNK, kërkon që drejtimi i shoqërisë të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre çmuarjeve. Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen. Në veçanti, informacion mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykime kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt material në vlerat kontabël në pasqyrat financiare përshkruhen në paragrafët në vijim.

Parimet e konsolidimit. Pasqyrat financiare të konsoliduara përfshijnë pasqyrat financiare të shoqërisë Posta Shqiptare sha dhe pasqyrat financiare të Interpost shpk. Interpost shpk është themeluar në Shkurt 2012 dhe zotërohet 100 përqind nga Posta Shqiptare sha. Ndërsa pjesëmarrja prej 3 përqind në kapitalin e shoqërisë Albtelecom sha është paraqitur me kosto.

Pasqyrat financiare të shoqërive janë përgatitur dhe i referohen të njëjtës datë raportimi me pasqyrat e konsoliduara. Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur të njëjtat parime të matjeve dhe njohjeve. Të gjitha mardhëniet e brendëshme midis kompanive të konsoliduara, të cilat kanë një vlerë të qenësishme janë eliminuar. Për të rritur kuptimin e pasqyrave financiare të konsoliduara nga përdoruesit, është paraqitur edhe informacioni individual i anëtarëve të Grupit që konsolidohet.

Transaksionet në monedhë të huaj. Transaksionet në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit.

Kurset e këmbimit me te rendesishme jane :	31 Dhjetor 2012	31 Dhjetor 2011
1 EUR	139.59	138.93
1 USD	105.85	105.70
1 CHF	115.99	110.97

Fitimi apo humbja nga kursi i këmbimit për zërat monetarë është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostove të amortizuara në monedhë të huaj të konvertuara me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me vlerë të drejtë konvertohen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është vendosur vlera e drejtë. Diferencat nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga konvertimi dhe njihen në pasqyrën e të ardhurave, përveç diferencave që rrjedhin nga konvertimi i instrumenteve të kapitalit të vlefshme për shitje (nëse ka).

Politikat kontabël

Njohja e te ardhurave. Te ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së marre ose për tu arkëtuar dhe përfaqëson vlerën e arketueshme për të mirat dhe shërbimet të siguruara gjatë aktivitetin normal të biznesit, neto nga zbritjet dhe shitjet të lidhura me taksën. Shitjet e mallrave njihen kur mallrat janë dërguar dhe gjithashtu kanë kaluar dhe pronësinë e tyre. E ardhura nga shërbimet e kryera njihet në pasqyrën e të ardhurave në përpjesëtim me volumin e shërbimit të kryer në datën e bilancit. Volumi i shërbimit vlerësohet duke iu referuarurvejimeve të punës së kryer. Transferimi i stkut mallra në sportele regjistrohet në të ardhura.

Tatimi mbi fitimin. Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e të ardhurave përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital. Në këto raste tatim fitimi njihet si zë i kapitalit. Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi të fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që hyn në fuqi menjëherë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme. Tatimi i shtyre është llogaritur duke përdorur metodën e bilancit, për diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe bazës tatimore. Shuma e tatimit të shtyre llogaritet në normën e tatimit që pritet të aplikohet në diferencat e përkohshme kur ato rimerren, bazuar në legjisllacionin tatimor që janë ose hyjnë në fuqi në datën e raportimit. Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit të mund të përdoren humbjet tatimore të papërdorura dhe kreditimet tatimore të papërdorura. Aktivi tatimor i shtyrë zvogëlohet për aq sa nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal.

Aktive afatgjata jomateriale. Zërat e aktiveve afatgjata jomateriale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi, (nëse ka). Aktivet afatgjata jomateriale me jetëgjatësi të papërcaktuar rishikohen nëse vlerësimi për jetëgjatësinë qëndron. Nëse jo, ndryshimi i vlerësimit duhet të bëhet në mënyrë prospektive.

Aktivitet afatgjata jomateriale me jetëgjatësi të përcaktuar amortizohen përgjithësisht mbi bazën e metodës lineare mbi jetën e dobishme dhe testohen për zhvlerësime në çdo datë raportimi. Ndryshimet në vlerësimin e jetëgjatësisë do të trajtohen si ndryshime në vlerësimet kontabël. Amortizimi i aktiveve afatgjata jomateriale kalon në shpenzimet e periudhës. Në vijimësi aktivitet afatgjata jomateriale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi, (nëse ka).

Aktive afatgjata materiale. Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi, (nëse ka). Në vitin 2008 ato kanë qenë objekt rivlerësimi.

Toka dhe ndertesa përfshijnë përgjithësisht ambientet e zyrave. E gjithë pasuria e paluajtshme, ndertesat dhe makinerite paraqiten në kosto, të rivlerësuar (siç përkrahëhet në paragrafin e mëposhtëm) minus amortizimin përkatës dhe zhvlerësimin, përveç për token, e cila pasqyrohet me koston e rivlerësuar minus zhvlerësimin. Kosto e aktiveve të ndertuara vete përfshijnë kostot e materialeve, punës direkte, si dhe çdo kosto tjetër që lidhet me sjelljen e këtyre aktiveve në gjendje pune dhe kostot për montimin dhe levizjen e tyre dhe përgatitjen e vendit në të cilin do të vendosen. Programet kompjuterike të blera që janë të nevojshme për vendosjen në funksion të këtyre aktiveve të cilat kapitalizohen si pjesë të këtyre makinerive. Aktivitet të cilat janë nxjerrje jashtë përdorimit kanë qenë të kontabilizuar me vlerën e bazuar në vlerën e tyre neto në datën e daljes jashtë përdorimit. Kostot e pjesëve të ndërrimit për makinerite dhe pajisjet njihen me vlerën e tyre kontabel nëse është e mundur që njesia ekonomike të përfitojë të ardhura ekonomike nga kjo pjesë dhe këto të ardhura mund të maten në mënyrë të besueshme. Kostot e mirëmbajtjes dhe riparimeve të përditshme të pasurive të paluajtshme, makinerive dhe pajisjeve njihen në fitim e humbje kur ato ndodhin.

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën lineare mbi vlerën e mbetur kontabel në mënyrë që, kosto e çdo aktivi deri në vlerën e mbetur, të shprehë përgjate të gjithë jetes se tij të dobishme si më poshtë:

EMERTIMI	JETEGJATESIA
Ndertesat	10 - 30 vjet
Instalime teknike, makineri e pajisje	5 vjet
Mjete transporti	5 vjet
Mobilje dhe orëndi	5 vjet
Pajisje zyra dhe informatike	4 vjet

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur (nëse nuk është e pakonsiderueshme) të aktiveve materiale afatgjate janë rishikuar në datën e raportimit. Toka dhe Ndertimet në Proces, si dhe parapagimet furnitoreve nuk amortizohen. Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit përcaktohen nga krahasimi i përfitimeve me vlerën e tyre kontabel. Këto përfshihen në pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve.

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundur që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuhen atij elementi do të rrjedhin Shoqërisë, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin.

Aktive afatgjata financiare. Aktivitet afatgjata financiare përfshijnë investimin në shoqërinë Altelecom sha. Kjo pjesëmarrje paraqitet me kosto, në përputhje me SNK 39, paragrafi 46, Investimet në Instrumenta Kapitali.

Investimi Interpost. Shoqëria Interpost shpk është në fazë investimi dhe nuk ka filluar të gjenerojë të ardhura. Për këtë qëllim, kostot e periudhës janë ngurtësuar dhe janë paraqitur në bilancin e gjendjes, me qëllim kalimin e tyre në rezultatin e periudhave përkatëse në përputhje edhe me gjenerimin e të ardhurave nga kjo kompani.

Aktivet e marra me qira. Aktivet e marra me qira janë të klasifikuara si qira financiare kur termat e transferimit të risqeve dhe pronësisë kalojnë të qiramarrësi. Të gjitha qeratë e tjera janë të klasifikuara si qera operative. Asetet që janë regjistruar si qera financiare regjistrohen si asetë të Shoqërisë me vlerën e drejtë në datën e fillimit të qerasë, ose me vlerën aktuale të minimumit të pagesave të qerasë nëse kjo e fundit është më e vogël. Pagesat e qerasë regjistrohen si shpenzimeve financiare dhe zvogëlimit të detyrimit të qerasë që të arrijë një normë konstante të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimit.

Inventarët. Mallrat vlerësohen me vlerën më të vogël të kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja përfshin materialet direkte dhe punën direkte kur është e aplikueshme dhe kostot e tjera që janë shpenzuar për të sjelle inventarët në gjendjen dhe vendin aktual. Vlera neto e realizuar tregon vlerën e çmuar të çmimit të shitjes në aktivitetin e biznesit, duke i zbritur koston e çmuar të marketingut, shitjes dhe shpërndarjes. Kostoja e inventarëve të tjerë është bazuar në parimin FIFO (e hyra e pare e dala e pare) dhe përfshin shpenzimet e përdorura në përvetësimin e inventarit dhe për të sjelle ato në kushtet dhe vendin e tyre ekzistues. Shuma e përshtatshme për zhvlerësim njihet në pasqyrën e të ardhurave kur ka një evidence objektive që aktivi është zhvlerësuar.

Instrumentet financiare. Instrumente financiarë jo-derivativë të Shoqërisë përfshijnë llogari të arketueshme, mjete monetare dhe ekuivalente me to, dhe llogari të pagueshme. Gjate periudhave të raportimit shoqëria ka investime në letra me vlerë. Instrumentet financiarë jo-derivativë janë matur fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumenta jo me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kostot e transaksionit që janë të lidhura drejtpërdrejt me përvetësimin e tyre. Njohja në vijim e instrumenteve financiarë joderivativë përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet në rast se Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare nuk njihen nëse të drejtat kontraktuale të Shoqërisë ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktivi financiar perdujone, ose të gjitha risqet dhe përfitimet e aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të një aktivi financiar janë regjistruar në datën e tregtimit, psh datën në të cilën Shoqëria zotohet të blejë ose të shesë aktivin. Detyrimet financiare nuk njihen nëse detyrimet e Shoqërisë të detajuara në kontratë mbarojnë, janë shlyer ose janë anuluar. Instrumentet financiarë jo-derivativë janë matur fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumenta jo me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kostot e transaksionit që janë të lidhura drejtpërdrejt me përvetësimin e tyre. Njohja në vijim e instrumenteve financiarë joderivativë përshkruhet më poshtë.

Mjete monetare dhe ekuivalente me to. Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë vlerat në arkë dhe llogaritë rrjedhëse në banka. Për qëllime të fluksit të mjeteve monetare, këtu përfshihen edhe depozitat në formën e garancisë për huatë me maturitet me pak se 3 muaj ose deri në 12 muaj nga data origjinale.

Kërkesa për arkëtim. Kërkesat për arkëtim njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe në vijim me kosto të pakësuar për humbjet për zhvlerësime.

Llogari të detyrime të pagueshme. Llogaritë e detyrimeve të pagueshme paraqiten me vlerën e drejtë dhe në vijim me kosto të amortizuar.

Instrumenta financiare të mbajtura me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes. Nuk paraqiten instrumenta financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes.

Hua dhe kredi. Në vijim të njohjes fillestare, huatë dhe kreditë paraqiten me kosto të amortizuar me ndonjë diferencë ndërmjet koston dhe vlerës së riblerjes që njihet në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar në normën e interesit efektiv.

Kapitali aksionar. Kapitali aksionar i Shoqërisë njihet me vlerën nominale.

Te tjera. Instrumenta financiarë të tjerë jo-derivativë maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, dhe duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi.

Zhvlërësimi i aktiveve. Në çdo datë të raportimit, shoqëria rishikon nëse ka arsye apo rrethana që vlera që mbartin aktivet financiare, të ndryshme nga ata të mbajtur me vlerën e drejtë, të jenë zhvlërësuar.

Aktivitet financiare. Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlërësuar nëse evidenca objektive zhvlërësimi tregon se një ose më tepër ngjarje që kanë ndodhur kanë patur një ndikim negativ në flukset e çmuara të ardhshme të mjeteve monetare të aktivitetit financiar. Humbja nga zhvlërësimi i një aktivi financiar të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferencë ndërmjet vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuar të mjeteve monetare skontuar me normën fillestare të interesit efektiv të aktivitetit financiar. Humbja nga zhvlërësimi i një aktivi financiar të vlefshëm për shitje është llogaritur kundrejt vlerës së tij të drejtë. Aktivitetet financiare të cilat janë të konsiderueshme individualisht testohen për zhvlërësim në baza individuale. Pjesa e mbetur e aktiveve financiare vlerësohet se bashku në grupe që mbartin karakteristika të ngjashme risku. Te gjitha humbjet nga zhvlërësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave. Ndonjë humbje kumulative në lidhje me aktivet financiare të vlefshme për shitje të njohura me pare në letra me vlerë transferohet tek humbje fitimi. Një humbje nga zhvlërësimi mund të anulohet nëse ulja në zhvlërësim ka ndodhur për shkak të një ngjarjeje që ka ndodhur pasi është njohur zhvlërësimi. Anullimi njihet në pasqyrën e të ardhurave.

Aktivitet jo-financiare. Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç inventarit dhe aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlërësim. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Humbje nga zhvlërësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlërësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave. Humbjet nga zhvlërësimi në periudhat e mëparshme janë rishikuar në çdo datë raportimi për rastet kur humbja rritet ose nuk ekziston më. Një humbje zhvlërësimi anulohet nëse ka patur ndryshim në vlerësimet e përdorura për caktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga zhvlërësimi anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, dhe sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga zhvlërësimi.

Përcaktimi i vlerës së drejtë. Disa nga politikat kontabël dhe shenimet e pasqyrave financiare e Shoqërisë kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, për të detyrimet dhe aktivet financiare dhe jo-financiare. Vlera e drejtë është përdorur për qëllime matjeje dhe zbulimi bazuar në metodat e mëposhtme. Kur është e aplikueshme, informacione të mëtejshme rreth supozimeve të bëra për vlerën e drejtë është paraqitur në shënimin specifik të aktiveve dhe detyrimeve.

Kërkesa për arkëtim nga debitorët. Vlera e drejtë e kërkesave për arkëtim, klientëve dhe llogarive të tjera të arkëtueshme, është matur si vlera aktuale e flukseve të ardhshme, të skontuara me normën e interesit të tregut në datën e raportimit.

Aktivitet afatgjata materiale. Vlera e drejtë e aktiveve afatgjata është përcaktuar nga profesionistë të fushës së vlerësimit. Vlerësimi është kryer në datën 31.12.2007. Shtesa e vlerës është paraqitur në seksionin e kapitalit si rezervë nga rivlerësimi, dhe kalohet gradualisht në fitimet e pashpërndara në përputhje edhe me amortizimin e aktiveve të vlerësuar.

Përfitimet e punonjësve. Shoqëria, në rrjedhën normale të biznesit të saj, kryen pagesa për llogari të saj dhe për llogari të punonjësve të saj për të kontribuar për pensionet në përputhje me legjislacionin lokal. Kontributet e Shoqërisë ndaj planit të pensioneve ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave kur ato ndodhin. Shoqëria njih si detyrim vlerën e paskontuar të kostove të parashikuara në lidhje me lejet vjetore që pritet të paguhet në këmbim për shërbimin e punonjësve për gjatë periudhës.

Provizionet. Provizionet njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose strukturor) si një rezultat i ngjarjeve të kaluara dhe është e mundur që një rrjedhje e burimeve duke personifikuar fitime ekonomike do të jete e nevojshme për të rregulluar detyrimin dhe një vlerësim të besueshëm të vlerës së detyrimit që mund të behet. Nëse efekti është material, provizionet llogariten duke zbritur vlerën e pritshme të mjeteve monetare të ardhme para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohe të parasë, dhe kur është e nevojshme riskun specifik të detyrimit. Provizionet paraqiten në çdo datë bilanci dhe nëse nuk është akoma e mundur që rrjedhja e burimeve duke personifikuar burime ekonomike të përdoret për rregullimet e detyrimeve, provizionet anulohen. Provizionet përdoren vetëm për qëllimet e njohura fillimisht. Provizionet nuk njihen për humbje shfrytëzuese të ardhme. Aktivitetet dhe detyrimet e rasti nuk njihen.

Kontabiliteti mbrojtës dhe instrumentet derivative financiare. Shoqëria nuk përdor instrumenta financiare mbrojtëse, pavarësisht se është e ekspozuar ndaj riskut financiar. Kjo për faktin se bursa nuk ekziston për të ofruar instrumenta derivativë.

Ndryshime në zbatimin e politikave kontabël. Shoqëria paraqet aktivet afatgjata me vlerë të drejtë dhe ka krijuar rezerva nga rivlerësimi. Këto rezerva janë krijuar në periudhën 2008 dhe për periudhat 2008, 2010 dhe 2011 këto rezerva janë rimarrë duke u transferuar në fitimet e periudhës për vlerat që paraqiten në tabelën në vijim.

	Periudha 2012	Periudha 2011	Periudha 2010	Periudha 2009	Periudha 2008	TOTAL
Rimarrje nga Rivlerësimi Asete Afatgjata	28,382,704	30,156,294	32,093,611	17,870,871	18,564,789	127,068,269

Për periudhën 2009 dhe 2012 rimarrja është transferuar direkt në fitimet e pashpërndara nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave gjithpërfshirëse.

2. Të ardhurat nga shitja

Paraqiten të ardhurat nga operacionet normale të biznesit. Te ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen ne pasqyren e te ardhurave ne varesi te fazes se transaksionit ne daten e raportimit. Asnje e ardhur nuk njihet nese ka pasiguri te larte lidhur me kryerjen e pageses dhe kostove perkatese. Te ardhurat nga shërbimet perfaqsojne shitjet nga aktiviteti kryesor si shërbim postar, financiar, telefonik, biznesi, eksporti etj. Te ardhurat e tjera perfaqsojen te ardhura nga veprimtaria e shfrytezimit, etj

	2012 ne Lek	2011 ne Lek
Te ardhura per shërbimin postar	811,450,943	817,282,904
Te ardhura per shërbimin telefonik	599,893	1,030,878
Te ardhura nga shërbimi financiar	885,742,222	843,854,637
Te ardhura nga shërbimi biznesi	31,191,548	36,387,620
Te ardhura nga ekspres	34,482,130	76,081,589
Te ardhura nga shërbimi eksporti	6,380,037	13,727,334
Te ardhura nga shërbimi nderkombetar	75,745,859	68,091,175
Të ardhura te tjera	21,528,275	2,750,040
TOTAL	1,867,120,908	1,859,206,177

3. Të ardhura të tjera

Paraqiten të ardhura të tjera që kanë rrjedhur gjatë periudhës, kryesisht perfaqsojne te ardhurat nga kontrata e dhenies se ambienteve me qera.

	2012 ne Lek	2011 ne Lek
Te ardhura te tjera	151,740	84,011
TOTAL	151,740	84,011

4. Shpenzime materiale dhe të konsumueshme

Shpenzimet e materialeve perfaqsojne kostot e materialeve, furnitura te ndryshme mallrave te konsumuara per zhvillimin e aktivitetit gjate periudhes ushtrimore.

	2012 ne Lek	2011 ne Lek
Materialet e konsumuara	88,277,752	65,129,544
Kosto e pulles	14,148,155	12,536,187
Konsumi i inventarit te lmet	7,737,259	2,755,243
Shpenzime karburanti	46,857,492	55,608,563
